

Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstva Prade - Ministry of Justice
SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS - PROBACIONA
SLUŽBA KOSOVA
KOSOVO PROBATION SERVICE
DREJTORIA QENDRORE

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	SHSK-MD/2024				
PËR/ZA/TO:	Znj. Albulena Haxhiu, Ministre në Ministrinë e Drejtësisë Z. Blerim Sallahu, Zv. Ministër në MD Z. Genc Nimoni, Këshilltar i Lartë dhe Shef i Kabinetit				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:	Arsim Tahiri, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues të Kosovës <i>Arsim Tahiri</i>				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i Shërbimit Sprovues të Kosovës Periudha: Janar-Dhjetor 2023				
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: RoomNo.:	604	Lokacioni: Kucni Extensin:	038 200 18 321	Data: Datum: Date:	Janar, 2024
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					<input type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					<input type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY TO DISCUSS					<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					<input type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					<input checked="" type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input checked="" type="checkbox"/>
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstva Pravde - Ministry of Justice
SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS - PROBACIONA SLUŽBA KOSOVA
KOSOVO PROBATION SERVICE

DREJTORIA QENDRORE

RAPORTI
JANAR-DHJETOR 2023

PRISHTINË, JANAR 2024

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
1. SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS, MASAT DHE DËNIMET ALTERNATIVE SI DHE TË LIRUARIT ME KUSHT NGA BURGU	5
1.1 Baza ligjore	5
1.2 Struktura organizative	5
1.3. Stafi i SHSK-së për vitin 2023.....	6
2. MASAT DHE DËNIMET ALTERNATIVE	9
2.1 Anketat sociale për të mitur	9
2.2 Raporte para ndëshkuese	10
2.3 EKZEKUTIMI I MASAVE DHE DËNIMEVE ALTERNATIVE	10
3. MBIKËQYRJA E PERSONAVE TË LIRUAR ME KUSHT	14
4. AKTIVITETET PËR REALIZIMIN E SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME	15
5. BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT TANË	16
6. NGRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE	17
PËRFUNIDIM	23

HJRJE

Ky raporti ofron informacione lidhur me ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative, mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht nga burgu, anketave të plota sociale për kryesit e mitur, raportet para ndëshkuese si dhe aktivitetet tjera konform ligjeve në fuqi.

Raporti paraqet informacione me të dhëna statistikore dhe narrative, të dhëna për strukturën organizative të SHSK-së, aktivitetet për realizimin e planit të punës, ngritja profesionale e stafit me anë të trajnimeve profesionale, bashkëpunimi me institucionet relevante vendore e ndërkombëtare, etj.

Shërbimi Sprovues i Kosovës, gjatë kësaj periudhe kohore ka vazhduar me realizimin e detyrave të punës si dhe programeve për punët sprovuese që për synim kanë ngritjen e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë në realizimin e tyre. Shërbimi Sprovues në këtë drejtim ka për qëllim realizimin dhe zbatimin me sukses të masave dhe dënimeve alternative, mbikëqyrjen e personave të dënuar, ngritjen e vetëdijes shoqërore, bashkëpunimin me të gjitha organet e pushtetit shtetëror, humanizmin e dënimeve, shqiptimin dhe zbatimin sa më të madh të masave dhe dënimeve alternative, reduktimin e krimit, zvogëlimin e shkallës së recidivizmit etj.

Gjithashtu, aktiviteti i Shërbimit Sprovues të Kosovës, është i shprehur në bashkëpunimin me institucionet e ndryshme dhe në veçanti: Prokuroria, Gjykata, Paneli për Lirim me Kusht, Policia e Kosovës, Shërbimi Korrektues dhe institucionet tjera. Vlen të theksohet, se masat dhe dënimet alternative dhe lirimi me kusht janë më të dobishme për shoqërinë dhe personin e dënuar dhe konsiderohen si dënime që kryen në komunitet dhe për këtë arsye ato konsiderohen më të dobishme, më ekonomike, ndikojnë në përkrahjen për të dënuarit, në mënyrë që ata të largohen nga kryerja e veprave penale dhe çfarëdo krimi në shoqëri ku jetojnë dhe veprojnë. Prandaj, përfitimet janë të dyfishta: si për kryesit e veprave penale, po ashtu dhe për shoqërinë dhe komunitetin që i përkasin në përgjithësi.

1. SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS, MASAT DHE DËNIMET ALTERNATIVE SI DHE TË LIRUARIT ME KUSHT NGA BURGU

1.1 Baza ligjore

Shërbimi Sprovues i Kosovës, punën e vet e bazon në Ligjin për Shërbimin Sprovues të Kosovës, si dhe ligjet penale në të cilat parashihen masat dhe dënimet alternative si dhe mbikëqyrja e personave të liruar me kusht nga burgu. Ndër të tjera puna e Shërbimit Sprovues bazohet edhe në këto ligje: Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Kodi i Drejtësisë për të Mitur. Gjithashtu, Shërbimi Sprovues i Kosovës është i përfshirë edhe në Ligjin për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), ku SHSK bënë pjesë në kuadër të Agjencive të Sigurisë Publike.

1.2 Struktura organizative

Shërbimi Sprovues i Kosovës, ka strukturën organizative bazuar në Ligjin për Shërbimin Sprovues, e cila përbëhet nga: Zyra Qendrore me seli në Prishtinë dhe zyrat rajonale të cilat shtrihen në nivel të gjykatave themelore në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të Drejtorisë Qendrore të SHSK-së, bëjnë pjesë: Departamenti për Ekzekutimin e Masave dhe Dënime Alternative, Departamenti për Lirim me Kusht dhe programe, si dhe Departamenti i Administratës. Kurse në nivelin lokal ka shtatë (7) zyra rajonale në tërë territorin e Republikës së Kosovës, si: Zyra Rajonale në Prishtinë, Zyra Rajonale në Prizren, Zyra Rajonale në Mitrovicë, Zyra Rajonale në Pejë, Zyra Rajonale në Gjilan, Zyra Rajonale në Ferizaj dhe Zyra Rajonale në Gjakovë, të cilat veprojnë sipas kompetencave territoriale të prokurorive dhe gjykatave themelore përkatëse.

Shërbimi Sprovues i Kosovës disponon me administratën e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve, duke siguruar konsultim dhe bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë si dhe koordinon dhe mbikëqyrë aktivitetet e Divizioneve, duke ofruar mbështetje profesionale për tërë Shërbimin Sprovues në lëmin e planifikimit të buxhetit, Planit të Rrjedhës së Parasë dhe Zotimeve, Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, mban evidencën e buxhetit, zotimeve, shpenzimeve dhe ruan faturat kopje në arkivin e

financave 33400 për ekzekutim, kurse, pagesat e faturave i kryen Divizioni i financave të MD-së.

Buxheti i Shërbimit Sprovues të Kosovës për vitin 2023 sipas ligjit të buxhetit të Republikës së Kosovës është i ndarë në këto kategori ekonomike:


Buxheti për vitin 2023 sipas kategorive	
Paga dhe Mëditje	564,636.13. €
Mallra dhe Shërbime	72,103.00 €
Shpenzime Komunale	19,000.00 €.
Totali	655,739.13 €

1.3. Stafi i SHSK-së për vitin 2023

Numri aktual i personelit të SHSK-së për vitin 2023 është gjithsej 61 ndërsa të planifikuar me buxhet janë 75 nëpunës.

Bazuar në të dhënat nga Sistemi për menaxhimin e burimeve njerëzore profili i moshës së nëpunësve jepet në grafikonin në vijim e ndarë me përqindje.

Grafiku: Profili i moshës së personelit të Shërbimit Sprovues



Personeli i SHSK-së është i kualifikuar me përgatitje adekuate për të gjitha pozitat. Gjithashtu, të gjithë zyrtarët sprovues apo menaxherët e rasteve të cilët punojnë drejtpërdrejtë me raste janë me përgatitje universitare në lëmine përkatëse, si: pedagogë, psikologë, sociologë, jurist, ekonomist etj.

Grafiku: Paraqitja përgaditjes profesionale e nëpunësve të Shërbimit Sprovues është:



Sa i përket gjinisë në Shërbimin Sprovues aktualisht nga numri i përgjithshëm i personelit numri i punonjësve femra prinë për 10% më i lartë në krahasim me numrin e punonjësve meshkuj.

Ndarja e nëpunësve sipas gjinisë është dhënë në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku: Ndarja e personelit sipas gjinisë



Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar procedurat që lidhen me rekrutimin e stafit, janë përgatitur vërtetime mbi marrëdhënien e punës për stafin e SHSK-së, Vendime lidhur me Pensionim gjatë vitit 2023 dhe çdo punë që lidhet a po ka të bëjë me punën e njësisë së burimeve njerëzore.

Sa i përket programit vjetor të planit të personelit të paraparë për çdo vit është hartuar planifikimi i personelit konform buxhetit të SHSK-së dhe është dorëzuar me kohë në njësinë përkatëse të Departamentit për menaxhimin e zyrtarëve publik. Po ashtu të gjitha njësitë përkatëse janë njoftuar për plotësimin e formularëve të vlerësimit të punës për punonjësit e SHSK-së konform Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe të Nëpunësve të Shërbimeve Publike, meqë ende nuk është hartuar Projekt-rregullorja për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe të Nëpunësve të Shërbimeve Publike sipas Ligjit Nr. 08/L - 197 për Zyrtar Publik.

Bazuar në Ligjin nr.06/L-114 për zyrtar publik gjatë këtij viti janë zhvilluar disa procese rekrutuese, prej tyre katër procese në pozitën nivel i mesëm drejtues dhe një proces me lëvizje paralele kurse, një pozite e nivelit administrativ u zhvillua me proces pranim i hapur.

Që nga hyrja në fuqi e Ligji Nr.08/L-197 për zyrtarët publik dhe Rregullores (QRK)Nr.15/2023 për pranimin dhe karrierën në Shërbimin civil të republikë së Kosovës janë shpallur 8 procedura të rekrutimit sipas listimit vijues:

Ferizaj tri procese për 3 zyrtar sprovues, Prishtinë dhe Mitrovicë me nga një vend punë për zyrtar sprovues kurse, për zyrtar administrativ janë dy procese një në Drejtorinë Regionale Pejë dhe një në Gjakovë si dhe një proces rekrutimi për pozitën udhëheqës i nivelit të ultë drejtues në Drejtorinë Regionale Pejë. Këto të fundit për shkak afateve procedurale vazhdojnë për vitin vijues.

Ndërsa procedurat e mëtutjeshme do pasojnë në vitin që vjen duke u përfshirë edhe pozitën për zyrtar administrativ Pejë dhe Gjakovë dhe udhëheqës regional Pejë.

Gjithashtu gjatë këtij viti pesë (5) punonjës nga Shërbimi Sprovues kanë përfunduar marrëdhënien e punës për shkak mbushjes së moshës së pensionimit prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjet.

2. MASAT DHE DËNIMET ALTERNATIVE

2.1 Anketat sociale për të mitur

Shërbimi Sprovues i Kosovës, ka bashkëpunime të shumta në procesin e hartimit të anketave, raporteve të ndryshme, përkatësisht në procesin e mbikëqyrjes është në kontakt të vazhdueshëm me këta persona, vizitojnë familjet e tyre, shkollat, qendrat për punë sociale si dhe institucionet e tjera relevante në regjionin përkatës në mënyrë që procesi i risocializimit dhe re integrimit të këtyre personave në shoqëri të jetë sa më i suksesshëm.

Duke u bazuar në Kodin e Drejtësisë për të Mitur, Shërbimi Sprovues përparatit anketë të plotë sociale për të miturin me kërkesë të prokurorit publik, gjyqtarit për të mitur ose gjykatës.

Tabela. Anketat sociale sipas zyrave rajonale të SHSK-së, gjatë periudhe janar dhjetor 2023

Nr. rend	Drejtoria Rajonale e SHSK- Anketat	Meshkuj	Femra	Gjithsej
1	Drejtoria Rajonale e Prishtinës	910	45	955
2	Drejtoria Rajonale e Prizren	164	14	178
3	Drejtoria Rajonale e Gjilanit	170	3	173
4	Drejtoria Rajonale e Mitrovicës	73	4	77
5	Drejtoria Rajonale e Pejës	234	15	249
6	Drejtoria Rajonale e Ferizajt	285	23	308
7	Drejtoria Rajonale e Gjakovës	112	2	114
	Gjithsej	1948	106	2054

Shërbimi Sprovues i Kosovës, në bazë të kërkesave zyrtare të prokurorive dhe gjykatave në nivel të vendit gjatë periudhës janar dhjetor 2023, ka pranuar kërkesë për hartimin e 2054 anketa të plota sociale për të mitur sipas kërkesave nga Prokuroria Themelore/Departamenti për të Mitur. Këtyre kërkesave, Shërbimi Sprovues i Kosovës, sipas zyrave rajonale (7 sosh), iu ka përgjigjur pozitivisht, përkatësisht i ka hartuar dhe i ka dorëzuar të gjitha me kohë.

Nga të dhënat statistikore shihet se numrin më të madh për kryerjen e anketave sociale e ka Drejtoria Rajonale e SHSK-së në Prishtinë, me 955 anketa sociale për të mitur, kurse më së paku ka pasur Drejtoria Rajonale e SHSK-s në Mitrovicë, gjithsejtë 77 kërkesa për anketa sociale.

2.2 Raporte para ndëshkuese

Shërbimi Sprovues gjatë kësaj periudhe ka pranuar një numër relativisht të madh të kërkesave për Raport para ndëshkues në krahasim me periudhat e tjera të viteve paraprake. Janë pranuar tetëmbëdhjetë (18) kërkesa për raport para ndëshkues. Nga ky numër 8 kërkesa kanë qenë raste madhore dhe 10 prej tyre persona të mitur. Këto raporte janë dorëzuar sipas kërkesave të gjykatave nga zyrat rajonale të SHSK-së ashtu siç është paraparë me legjislacionin pena dhe specifikisht Kodin e Drejtësisë për të Mitur, ku thuhet se: Para zgjedhjes së masës apo dënimit, gjykata kërkon nga Shërbimi Sprovues Raport para ndëshkues apo (para shqiptimit të dënimit) dhe mendimin lidhur me zgjedhjen e masës apo dënimit si dhe në bazë të Ligjit për Ekzekutimin e Sankcioneve Penale, parasheh raportin para shqiptimit të dënimit nga gjykata, ku thuhet: Para shqiptimit të dënimit alternativ, gjykata mund të kërkojë raport nga Shërbimi Sprovues. Shërbimi Sprovues ia dorëzon raportin gjykatës para shqiptimit të dënimit, brenda tri (3) javësh nga paraqitja e kërkesës së tillë, dhe Raporti i dhënë para shqiptimit të dënimit përcakton dënimin, apo dënimet alternative adekuate për personin e dënuar duke pasur parasysh objektivat e risocializimit dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale në të ardhmen”.

2.3 EKZEKUTIMI I MASAVE DHE DËNIMEVE ALTERNATIVE

Shërbimi Sprovues i Kosovës, përkatësisht, zyrtarët sprovues dhe punonjësit tjerë të këtij shërbimi, gjatë kësaj periudhe, duke u bazuar në kërkesat e prokurorive dhe gjykatave, lidhur me ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative, pastaj në ri integrimin dhe në risocializimin e personave me masa dhe dënime alternative, kanë kryer të gjitha obligimet në afat ligjorë. Zhvillimi i proceduarave të punës me këta persona kryhet në mënyrë profesionale, sipas programit individual të punës, i cili hartohet nga zyrtarët sprovues. Shërbimi Sprovues për të gjitha rastet të cilat i ka në trajtim, ka për qëllim që të bëjë zbatimin efektiv të vendimeve të prokurorisë apo gjykatës, duke u bazuar në nevojat që kanë këto raste, pastaj, bëjnë plane individuale të mbikëqyrjes për masën apo dënimin e caktuar në bashkëpunim me institucione të tjera, me qëllim të ri socializimit, re integrimit dhe rehabilitimit të tyre në shoqëri. Gjatë kësaj

periudhe Shërbimi Sprovues ka pranuar një numër të madh të rasteve me të cilat ka nis punën për mbikëqyrje të zbatimin të vendimeve gjyqësore.

Tabela: Numri i rasteve të reja me masa dhe dënime alternative të pranuar gjatë periudhës janar dhjetor 2023

Lloji i rastit	Madhor	Mitur	Totali
Masë edukative	/	278	278
Masë e diversitetit	/	181	181
Masë e trajtimit të detyrueshëm	25	8	33
Dënimi me kusht	135	2	137
Dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme	37	27	64
Përkujdesje pas lirimit	/	22	22
<i>Gjithsej</i>	197	518	715


Shërbimi Sprovues, gjatë kësaj periudhe kohore raportuese, ka pranuar 715 raste për mbikëqyrje. Të gjitha këto raste janë proceduar konform punës të paraparë me rregulloren e punës si dhe procedurave ligjore.

Shërbimi Sprovues ka ndërmarr të gjitha hapat për realizimin e mbikëqyrjes së personave me masa dhe dënime alternative për këtë periudhe raportuese.

Tabela: Rastet me masa dhe dënime alternative të mbikëqyrura gjatë periudhës janar dhjetor 2023

Lloji i rastit	Madhor	Mitur	Totali
Masë edukative	/	714	714
Dënimi me kusht	479	12	491
Masë e trajtimit të detyrueshëm	89	14	103
Masë e diversitetit	/	265	265
Dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme	87	50	137
Përkujdesje pas lirimit	/	72	72
<i>Gjithsej</i>	655	1127	1782

Nga numri i përgjithshëm i rasteve të cilat kanë qenë në mbikëqyrje me masa apo dënime alternative, numrin më të madh të rasteve e përbejnë personat e mitur me gjithsejtë 1127 raste dhe 655 raste persona madhor. Kryesisht dominojnë raste me masa të diversitetit dhe masa edukuese për të mitur, ndërsa tek personat madhor rastet e dënimit me kusht janë rastet me numër më të madh të shqiptuar si dhe rastet me punë në dobi të përgjithshme në numër më të vogël.



Numri më i madh i rasteve sa i përket dënimeve alternative për persona madhor është Dënim me Kusht me gjithsejtë 479 raste, me pas Dënim me Urdhër për Punë në Dobi të Përgjithshme me gjithsejtë 87 raste dhe Masë e Trajtimit të Detyrueshëm gjithsejtë 89 raste. Shërbimi Sprovues vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet kryer nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për të cilën personi i dënuar do të kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet dhe e mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.

Shërbimi Sprovues i Kosovës gjatë kësaj periudhe kohore ka bashkëpunuar me Shërbimin Korrektues të Kosovës (Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan), lidhur me Programin e Përkujdesjes pas Liritimit për të Mitur, sipas moduleve të Programit të Përkujdesjes si dhe të gjitha institucionet relevante. Shërbimi Sprovues i Kosovës ka pas në mbikëqyrje 72 persona të mitur të cilët janë mbikëqyrë sipas Planit të përkujdesjes pas liritimit.

Gjithashtu në tabelat vijuese paraqiten të dhënat për kryesit e veprës penale për dhunë në familje të cilëve u është shqiptuar masë apo dënim të cilët janë mbikëqyrë nga Shërbimi Sprovues.

Tabela: Rastet me vepër penale për dhunë në familje pranuar janar- dhjetor 2023 për kryesit e mitur

Lloji i rastit	Vepra	Neni	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Masë diversiteti	VPK-martësës dhe familjes	Dhuna në familje	7		7
Masë edukative	VPK-martësës dhe familjes	Dhuna në familje	1		1
Dënim me kusht	VPK-martësës dhe familjes	Dhuna në familje	2		2
Masë e trajtimit të detyrueshëm	VPK-martësës dhe familjes	Dhuna në familje	4		4
Përkujdesje pas lirimit	VPK-martësës dhe familjes	Dhuna në familje	1		1
			Gjithsej		15

Te miturit me kete lloje vepre kryesisht u eshtë shqiptuar mase e diversitetit por edhe denime me kusht si dhe mase e trajtimit te detyrueshme qe jane rastete me te shpeshta. Sa i perket persoanve madhore ne tabelen ne vazhdim paraqiten rastet sipas veprave te cilat jane mbikqyrur nga SHSK.

Tabela: Rastet me vepër penale për dhunë në familje pranuar janar- dhjetor 2023 për kryesit madhor

Lloji i rastit	Vepra	Neni	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Masë e trajtimit të detyrueshëm rehabilitues	VPK-martësës dhe familjes	Dhuna në familje	14	4	18
Dënim me kusht	VPK-martësës dhe familjes	Dhuna në familje	81	8	89
Lirim me kusht	VPK-martësës dhe familjes	Dhuna në familje	7		7
			Gjithsej		114

3. MBIKËQYRJA E PERSONAVE TË LIRUAR ME KUSHT

Shërbimi Sprovues i Kosovës gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, ka pas në mbikëqyrje 625 persona të liruar me kusht nga burgju, sipas aktvendimeve të Panelit për Lirim me Kusht.

Tabela: Numri i personave të liruar me kusht

Persona të liruar me kusht gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2023						
Nr.	Zyra Rajonale	Struktura e rasteve të reja		Gjithsej	Të bartura	Gjithsej në mbikëqyrje
		M	F			
1	Prishtinë	106	4	110	59	169
2	Prizren	47	1	48	34	82
3	Gjilan	31	1	32	19	51
4	Mitrovicë	56	2	58	40	98
5	Pejë	53	1	54	33	87
6	Ferizaj	47	1	48	18	66
7	Gjakovë	45	1	46	26	72
Gjithsej		385	11	396	229	625

Shërbimi Sprovues i Kosovës gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2023 ka pas në mbikëqyrje 625 persona të liruar me kusht nga burgju. Gjatë kësaj periudhe, nga burgju janë liruar 396 persona, kurse 229 rastet e tjera janë bartur nga vitet paraprake. Gjatë periudhës raportuese, mbikëqyrjen e kanë përfunduar 396 persona të liruar me kusht, kurse 229 të tjerë janë ende në mbikëqyrje të Shërbimit Sprovues. Nga numri i përgjithshëm i personave të liruar me kusht në vitin 2023, persona madhor janë 377, kurse 8 persona janë të mitur. Prej tyre, 385 raste janë meshkuj, kurse 11 raste janë femra.

Për të gjithë personat e liruar me kusht nga burgju, zyrtarët sprovues të SHSK-së, kanë hartuar programe individuale të punës lidhur me mbikëqyrjen si dhe raporte informative, periodike dhe përfundimtare.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2023, për personat e liruar me kusht nga burgu, janë përgatitur 918 raporte për Panelin për Lirim me Kusht. Prej tyre, 522 raporte informative dhe periodike si dhe 396 raporte përfundimtare. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe Shërbimi Sprovues ka pranuar 40 kërkesa nga të liruarit me kusht për dalje jashtë shtetit, të cilat i janë përcjellë Panelit për Lirim me Kusht për shqyrtim. Prej tyre, 29 kërkesa për dalje jashtë shtetit janë aprovuar, kurse 11 kërkesa të tjera janë refuzuar nga ana e Panelit për Lirim me Kusht.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023, Paneli për Lirim me Kusht i ka revokuar lirimin me kusht 16 personave (bazuar në raportet e zyrtarëve sprovues), për shkak të mos respektimit të procedurave ligjore të cilat janë të parapara me legjislacionin në fuqi.

4. AKTIVITETET PËR REALIZIMIN E SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME

Sa i përket realizimit të punëve që lidhen me shërbimet e përgjithshme janë ndërmarrë një varg aktivitetesh për realizimin e detyrave në përmbushjen e objektivave dhe planin e punës. Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë veprimet si në vijim:

Janë pranuar dhe protokolluar :

1. Fatura
2. Vendime
3. Shkresa hyrëse dhe dalëse të ndryshme
4. Kërkesa për zotime etj.

Transporti i Shërbimit Sprovues disponon 11 automjete për mbështetje logjistike të gjitha Zyrrave Rajonale të Shërbimit Sprovues. Prej të cilave 3 vetura janë me qira dhe një me defekt. Gjendja e këtyre automjeteve duket u bazuar në vitin e prodhimit nuk mund të themi se është edhe aq e mirë. Puna në teren kryhet me vetura zyrtare nga ana e zyrtarëve sprovues për të gjitha rastet e trajtimit të tyre. Kjo punë ka kosto të shpenzimeve lidhur me kryerjen e Anketave sociale, ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative dhe për mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht nga burgu, me qëllim të marrjes së sa më shumë informata të duhura nga gjithë faktorët në komunitet si: vizita familjare për klientët e SHSK-së dhe në institucione të ndryshme si: Qendra për Punës Sociale, Polici, Komuna, Shkolla dhe institucione tjera për realizimin e punëve sprovuese etj.

5. BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT TANË

Shërbimi Sprovues i Kosovës, gjatë këtij viti ka pasur një sërë aktivitete në realizimin me sukses të detyrave në ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative si dhe mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht, në këtë drejtim ka shprehur bashkëpunim të duhur me të gjithë partnerët, sugjerimet dhe ndihma e të cilëve e kanë avancuar punën e SHSK-së. Partnerët me të cilët ka bashkëpunuar në vazhdimësi SHSK, janë:

- UNICEF- Programi i Përkujdesjes Pas lirimit për të mitur (Kodin e Drejtësisë për të Mitur), Zbatimi i masave të diversitetit.
- Zyra e Bashkimit Evropian (BE-së) në Kosovë- Projekte të ndryshme që lidhen me zbatimin e masave dhe dënimeve alternative;
- EULEX
- Avokati i Popullit;
- KMLDNJ- Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut
- KOMF-Koalicioni i Organizatave për Mbrojtjen e fëmijëve
- ICITAP-in, Bashkëpunimin në mes SHKK-së dhe SHSK-së
- IRZ;
- UNDP;
- KGJK, KPK, IGJK, AKSP, IKAP-i,
- Oda e Avokateve të Kosovës,
- Qendrat e Shëndetit Mendor sipas zyrave rajonale të SHSK-së,
- Universiteti "Hasan Prishtina" Fakulteti Filozofik;
- OJQ-të dhe organizatat tjera bashkëpunuese, siç janë:
- Save the Children,
- Terre des Hommes,
- Fondacioni Together
- HELP - Kosovo
- OSBE
- IOM
- PEN, etj.

6. NGRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe të vitit 2023 Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK) ka realizuar detyrat sipas dinamikës së punës me qëllim të realizimit të objektivave të punës konform prioriteteve. Duke pas parasysh prioritete, SHSK ka vazhduar me mbikëqyrjen e rasteve me masa dhe dënime alternative duke respektuar afatet dhe kushtet e parapara me vendime gjyqësore.

Në periudhën janar dhjetor të vitit 2023 janë realizuara këto aktivitete lidhur me aspektin e ngritjes profesionale dhe performancës në punë:

- ✓ Janë realizuar takime me udhëheqësit e gjykatave dhe prokurorive në disa regjione me qëllim të rritjes së bashkëpunimit në mes të institucioneve të drejtësisë për mbikëqyrjen më të mirë të ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative.
- ✓ Hartimi i draft rregullore së brendshme të SHSK-së, me çka do të plotësohet kuadri ligjor për funksionimin më të mirë të institucionit. Kjo rregullore ka kaluar procesin e vleresimit në Ministri të Punëve të brendshme dhe në vitin 2024 pritet të aprovohen nga ana e Qeverisë së Kosovës sipas procedurave standarde.
- ✓ Ngritja e vetëdijes së opinionit profesionist për rëndësinë e shqiptimit të masave dhe dënimeve alternative është prioritet i rëndësishëm i SHSK-së, krahas ngritjes së kapaciteteve institucionale janë realizuar takime të ndryshme me partnerë të ndryshëm lidhur me rëndësinë e zbatimit të masave dhe dënimeve alternative në përgjithësi. Në kuadër të kësaj agjende në vazhdimësi zhvillohen takime të rëndësishme me gjyqtar, prokuror dhe avokat me SHSK për të diskutuar rreth punës dhe rëndësisë së masave dhe dënimeve alternative.
- ✓ Është finalizuar dokumenti për standardet dhe procedurat e punës së Shërbimit Sprovues. Ky dokument është rishikuar dhe plotësuar konform ndryshimeve legislative që lidhet me punën e Shërbimit në përgjithësi dhe është aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SHSK-së.

- ✓ Është hartuar Strategjia zhvillimore dhe plani i veprimit 2023-2025 për Shërbimin Sprovues. Ky dokument është aprovuar nga Ministria e Drejtësisë dhe i njëjti ka hyrë në fuqi.
- ✓ Shërbimi Sprovues ka hartuar udhëzimin administrativ për kriteret dhe afatet kohore të përpilimit të raporteve dhe mbikëqyrjes së personave të liruar me kusht. Udhëzimi është dorëzuar në departamentin ligjor të MD-së për rishikimin dhe plotësimin e fundit sipas standardeve të udhëzimeve administrative dhe më pas pritet të nënshkruhet nga Ministria e Drejtësisë znj. Albulena Haxhiu.
- ✓ Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK) dhe Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) kanë nënshkruar një Marrëveshje të Mirëkuptimit për të thelluar bashkëpunimin në fushën e trajnimeve dhe zhvillimit të kapaciteteve. Kjo marrëveshje është një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të një partneriteti të fortë midis dy institucioneve përkatëse.
- ✓ Shërbimi Sprovues i Kosovës përkatësisht 16 punonjës të SHSK te udhëhequr nga Drejtori i Përgjithshëm kane marr pjese në një vizite studimore përkatësisht trajnimi në Maryland të SHBA-ve nga data 02-17 dhjetor. Në këtë trajnim i cili u mbajte nga profesionist të fushës se shërbimit sprovues të Marlyland-it, zyrtaret e SHSK-se u certifikuan me diplome te vijueshmërisë se trajnimit me gjithsejtë 80 orë trajnim.
- ✓ Shërbimi Sprovues në bashkëpunim me fondacionin gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar - IRZ ka zhvilluar tryeza diskutimi lidhur me temën "Bashkëpunimi ndërsektorial ndërmjet shërbimit sprovues, gjyqësorit si dhe prokurorisë në lidhje me masat dhe dënimet alternative me fokus në drejtësinë për të mitur". Ky organizim ishte me qëllim të bashkëpunimit në shkëmbim nder sektorial dhe krahasues të ekspertizës dhe përvojës në lidhje me masat alternative në shërbimin korrektues dhe shërbimin sprovues sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur.
- ✓ Shërbimi Sprovues vazhdon dinamikën e takimeve dhe bashkëpunimit ndërinstytucional me donator, OJQ dhe palë të interesit qoftë në marrjen e

praktikave dhe njohurive nga ekspertë të ndryshëm po ashtu edhe në ofrimin e mbështetjes logjistike.

- ✓ Gjatë kësaj periudhe të vitit 2023 u zhvillua një punëtori e përbashkët mes Shërbimit Sprovues dhe Shërbimit Korrektues e cila u organizua nga UNICEF-i. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte rishikimi i kurrikulës për të mitur në qendrën edukuese korrektuese.
- ✓ Në vazhden e bashkëpunimit me Akademinë e Drejtësisë, Shërbimi Sprovues vazhdimisht ofron ekspertizën e punës për njoftimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinjë lidhur me punën praktike në zbatimin e masave dhe dënimeve alternative. Në këtë kuadër është organizuar një trajnim së bashku me gjyqtarë dhe prokurorë si dhe zyrtarë të Shërbimit Sprovues me temën ndryshimet ligjore në kodin e drejtësisë për të mitur.
- ✓ Trajnerët e Shërbimit Sprovues kanë ofruar sesione trajnuese të programit biseda për ndryshim për zyrtarët social të Shërbimit Korrektues si dhe është i gatshëm të ofroj sesione tjera trajnuese nga të gjitha programet që zyrtarët e SHSK-së janë të certifikuar si trajner.
- ✓ Zyrtarë nga Shërbimi Sprovues kanë marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga Fondacioni gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ) lidhur me forcimin e sistemit të drejtësisë për të mitur. Kjo punëtori kishte për qëllim marrjen e njohurive profesionale ku përmes këtij lloj trajnimi u diskutua për cilësinë dhe reflektimin e masave kundër varësisë në institucion. Ky trajnim u mbajt së bashku me zyrtarë të SHKK-së në Qendrën korrektuese në Lipjan;
- ✓ Shërbimi Sprovues ka marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Rrjeti i grave të Kosovës në bashkëpunim me strehimoren "Shtëpia e sigurt në Gjakovë". Temë e këtij trajnimi ishte "Zbatimi i Protokollit Shtetëror të Trajtimit të Rasteve të Dhunës Seksuale";
- ✓ Shërbimi Sprovues ka marrë pjesë në një trajnim i cili u organizua nga BIRN në kuadër të projektit "Resilientt Community Program" me temë Kompetencat dhe përgjegjësia e institucioneve në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm;

- ✓ Shërbimi Sprovues ka marrë pjesë në disa sesione trajnimi të organizuar nga Qendra Kosovare për studime të sigurisë /QKSS në kuadër të projektit lidhur me temën “ Përdorimi i mjeteve dhe metodave për vlerësimin e rrezikut ndaj radikalizmit-sfidat, mundësitë dhe praktikat e huaja. Sesionet e tjera pritet të vazhdojnë gjatë muajve në vijim.
- ✓ Zyrtarë nga Shërbimi Sprovues kanë marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga Fondacioni gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ) lidhur me forcimin e sistemit të drejtësisë për të mitur. Kjo punëtori kishte për qëllim marrjen e njohurive profesionale ku përmes këtij lloj trajnimi u diskutua për cilësinë dhe reflektimin e masave kundër varësisë në institucion. Ky trajnim u mbajt së bashku me zyrtarë të SHKK-së në Qendrën korrektuese në Lipjan;
- ✓ Shërbimi Sprovues në fillim të muajit mars morri pjesë në hapjen e trajnimit me temë: Programi i Trajtimit Psikosocial në punën me Kryerësit e Dhunës në Familje trajnim ky i organizuar nga EUKOJUT i cili u mbajt në hotel “Sirius” në Prishtinë. Këtë trajnim e vijuan disa zyrtarë nga të gjitha drejtoritë rajonale të Shërbimit Sprovues me ç`rast certifikimi u realizua me rastin e përfundimit të këtij trajnimi;
- ✓ Zyrtarë nga Shërbimi Sprovues morën pjesë në punëtorinë e organizuar nga EUKOJUST lidhur me vlerësimin dhe monitorimin e programit, ndryshimet dhe metodat e trajtimit të intervistës motivuese për stafin e SHKK-së;
- ✓ Shërbimi Sprovues ka marrë pjesë në tryezë të përbashkët e cila u organizua nga Forumi i gruas së gjyqtarëve dhe prokurorëve me temë “Roli i zyrtarit sprovues në procedurat penale për të mitur;
- ✓ Shërbimi sprovues morrën pjesë në një punëtori e organizuar nga projekti “Resilient Community Program”, BIRN. Tema e kësaj e punëtorie ishte me qëllim të përforcimit të rolit të institucioneve në parandalimin e përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit në Kosovë si dhe përforcimit të procesit ri-integrues dhe risocializues;

- ✓ Zyrtarë nga Shërbimi Sprovues kanë marr pjesë në takimin e Mekanizimit kundër dhunës në familje për finalizimin e draft dokumentit të Planit Kundër Dhunës në Familje në Komunën e Gjakovës.
- ✓ Gjatë kësaj periudhe se bashku me përfaqësues nga Kabineti i Ministrisë së Drejtësisë dhe Shërbimi Korrektues, Shërbimi Sprovues ishte pjesë e një vizite zyrtare në Suedi. Qëllimi i kësaj vizite ishte marrja e praktikave dhe njohurive lidhur me punën, rolin dhe funksionimin e shërbimit sprovues të këtij shteti si dhe mundësia për lidhjen e një marrëveshjeje mes dy ministrive Kosovë-Suedi.
- ✓ Një përfaqësues nga Shërbimi Sprovues konkretisht udhëheqësi i divizionit për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për madhor ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga Këshilli i Evropës me temë “ Rritja e bashkëpunimit në Ballkanin perëndimor për menaxhimin e ekstremizmit të dhunshëm në burgje dhe parandalimin e radikalizmit të mëtejshëm pas lirimit”. Ky takim është realizuar në Podgoricë/ Mali i zi në kohëzgjatje prej dy (2) ditësh.
- ✓ Gjithashtu Shërbimi Sprovues konkretisht udhëheqësi i divizionit për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për madhor ka marrë pjesë në një vizitë zyrtare në Vienë të Austrisë ku temë e këtij lloj trajnimi ishte çështja e radikalizmit dhe vlerësimi i rrezikut e organizuar nga projekti EUTEX. Kjo vizitë tre ditore u realizua nga 22 - 24 mars 2023.
- ✓ Në kuadër të vazhdimësisë së projektit EUTEX, Udhëheqësi i Divizionit për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për madhor morri pjesë në trajnimin e ofruar nga ky projekt lidhur me temat që kanë të bëjnë me radikalizmin dhe reintegrimi. Kjo vizitë tre ditore prej 19- 21 prill 2023 u realizua në Stokholm të Suedisë.
- ✓ Një përfaqësues nga Shërbimi Sprovues konkretisht udhëheqësi i divizionit për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për të mitur me ftesën e Council of International Felloëship (CIF- International), ka marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare “ Drejtësia sociale dhe qëndrueshmëria për profesionistë”. Kjo

konferencë është zhvilluar në Hannover-Gjermani në kohëzgjatje prej pesë (5) ditësh.

- ✓ Trajnime të menaxhimit të rasteve të organizura nga Terre Des Hommes lidhur me Masat e Diversitetit me pjesëmarrjen e të gjitha zyrave rajonale me numer të caktuar të zyrtarëve.
- ✓ Trajnim i organizuar për zyrtarët e Shërbimit Sprovues si dhe menaxhmentin e zyrave rajonale përmes Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) me mbështetjen e ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë dhe Mbretërisë së Holandës janë duke zbatuar projektin e titulluar "Ofrimi i mbështetjes profesionale për Shërbimin Sprovues të Kosovës gjatë përballjes me terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm". Trajnimi është organizuar në dy pjesë dhe në grupin e parë kanë marr pjesë zyrtarët sprovues nga të gjitha zyrat rajonale dhe në grupin e dytë kanë marr pjesë udhëheqësit e zyrave rajonale së bashku me zyrtarët sprovues. Tjanimet janë mbajtur në periudhën e fundit të vitit 2023.

PËRFUNIDIM

- ✓ Shërbimit Sprovues i Kosovës, gjatë kësaj periudhe kohore të punës janar- dhjetor të vitit 2023, ka arritur ti realizojë me sukses detyrat dhe objektivat në harmoni me bazën ligjore në fuqi.
- ✓ Një prej detyrave më të rëndësishme të realizuara gjatë kësaj periudhe është hartimi i dokumenteve të punës dhe plotesim/ndryshimi i tyre konform ndryshimeve ligjore. Dokumentet më të rëndësishme të punuara në këtë vit janë standartete e punës si dhe plani zhvillimor strategjik i SHSK-së.
- ✓ Shërbimi Sprovues ka punuar në vazhdimësi në ngritjen e kapaciteteve profesionale si dhe Sensibilizimin e opinionit profesionist në bashkëpunim me gjykata, prokurori, avokat, etj., për shqiptimin më të madh të masave dhe dënimeve alternative, duke përfshirë stafin profesional në SHSK si dhe informimi i opinionit të gjerë profesionist me efektet pozitive të masave dhe dënimeve alternative;
- ✓ Janë realizuar aktivitete të ndryshme të trajnimeve, seminareve, vizita profesionale, punëtori, tryeza të punës me akter të ndryshëm profesional si me prokurorë, gjyqtarë, avokatë, ekspertet të fushave të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, lidhur me mbikëqyrjen e personave me masa e dënime alternative dhe lirim me kusht etj.
- ✓ Bashkëpunimin ndërinstitucional është rritur në këtë periudhë, janë mbajtur një varg takimesh me donator, OJQ dhe palë të interesit. Shërbimi Sprovues ka vazhduar bashkëpunimin me agjencionet e sigurisë publike në kuadër të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP).

Si Konkluzion - Viti 2023 për Shërbimin Sprovues ka rezultuar mjaft i rëndësishëm për arsye të finalizimit të dokumentave strategjike të cilat do t'a bëjnë punën tonë edhe më kualitative në kuptim të rritjes së sigurisë në komunitet dhe krejt kjo falë ngritjes së kapaciteteve profesionale të Shërbimit Sprovues të Kosovës si dhe planifikimit, organizimit, strukturimit dhe zbatimit të politikave të shëndetshme nga menaxhmenti i Shërbimit Sprovues të Kosovës.